



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/153  
Datë: 26.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 korrik 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Odën Ekonomike të Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada – Government*  
*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë*  
**Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine**  
**Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade**

---

**KONCEPT DOKUMENTI PËR ODËN EKONOMIKE TË KOSOVËS**

## PËRMBAJTJA

Përmbledhje e Koncept Dokumentit për OEK.....	3
<b>Hyrje</b> .....	5
<b>Kapitulli 1: Përkufizimi i Problemit</b> .....	7
<b>Kapitulli 2: Objektivat</b> .....	12
<b>Kapitulli 3: Opsionet</b> .....	14
<i>Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim</i> .....	16
<i>Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore</i> .....	16
<i>Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë</i> .....	17
<b>Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme</b> .....	18
4.1. <i>Ndikimet ekonomike</i> .....	18
4.2. <i>Ndikimet shoqërore</i> .....	19
4.3. <i>Ndikimi në të drejtat themelore</i> .....	19
4.4: <i>Sfidat me mbledhjen e të dhënave</i> .....	19
<b>Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi</b> .....	21
<b>Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve</b> .....	23
<i>Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme</i> .....	23
<i>Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet</i> .....	26
<b>Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm</b> .....	28
<i>Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin</i> .....	29
<i>Kapitulli 7.2: Dispozitat për monitorimin</i> .....	29
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik.....	30
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore .....	33
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore .....	37
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore .....	39

Përmbledhje e Koncept Dokumentit për OEK

<b>Informacionet e përgjithshme</b>	
Titulli	Koncept Dokumenti për Odën Ekonomike të Kosovës
Ministria bartëse	<i>Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë</i>
Personi kontaktues	Igballe Rexha-Jashari, zv Drejtore e Departamentit të Tregtisë Igballe.Rexha@rks-gov.net
PSO	Hartimi i koncept dokumentit për Odën Ekonomike është planifikuar në kuadër të Programit Strategjik dhe Operacional (PSO) të Qeverisë së Republikës së Kosovës, aktivitet ky i planifikuar për vitin 2022 në kuadër të shtyllës 1. Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe zhvillimi i konkurrueshmërisë në sektorin privat, nënshlylla 1.2 Përmirësimi i kornizës Ligjore për Odat Ekonomike.
Prioriteti strategjik	Në kuadër të Programit të Qeverisë së Kosovës 2021-2025, në kuadër të kapitullit 2.8 Industria, ndërmarrësia dhe tregtia; në mënyrë indirekte është potencuar rëndësia e zhvillimit të politikave industriale dhe tregtare me qëllim të përmirësimit të dialogut publiko-privat, bashkëpunim i strukturuar me komunitetin e biznesit me qëllim për zhvillim të përgjithshëm ekonomik.

<b>Vendimi</b>	
Çështja kryesore	Ndërveprimi i organizuar me nivele të ndryshme të qeverisë, qasja e garantuar tek autoritetet dhe pjesëmarrja zyrtare në politikat dhe proceset legjislative
Përmbledhje e konsultimeve	Takimet – planifikimi (të caktohen nga GP) Konsultime tjera do të zhvillohen gjatë procesit të konsultimit paraprak dhe publik të paraparë me Rregulloren e Punës së Qeverisë. Data e fillimit të konsultimit paraprak është 04.01.2023
Opsioni i propozuar	Ligji i ri për Odën Ekonomike të Kosovës

<b>Ndikimet kryesore të pritshme</b>	
Ndikimet buxhetore	Ka kosto shtesë
Ndikimet ekonomike	Në mbrojtjen e bizneseve nxitjen e një mjedisi të favorshëm ekonomik dhe propozimin e masave për përmirësimin e politikës ekonomike
Ndikimet shoqërore	Në interesat e përbashkëta për avansimin e veprimtarive afariste me ndikim në zhvillimin socio\ekonomik të vendit
Ndikimet mjedisore	Përmes shoqatave të bizneseve me ndikim në mjedis, stimulimi i bizneseve në mbrojtje të ambientit dhe harmonizimi i interesave ekonomike dhe sociale në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm
Ndikimet ndër-sektoriale	Ka ndikime relevante të pritshme në të gjitha kategoritë e bizneseve dhe fushveprimtaritë e tyre
Ngarkesat administrative për kompanitë	Lehtësirat administrative

Koncept dokumenti për Odën Ekonomike të Kosovës

Testi i NVM-ve	NVM janë anëtare të shoqatave sektoriale respektivisht të ODËS Ekonomike
----------------	--

<b>Hapat e ardhshëm</b>	
Afatshkurtër	Hartimi i Ligjit
Afatmesëm	Nxjerrja e akteve nënligjore /Zbatimi

## Hyrje

Me Ligjin nr. 2004/7, për Odën Ekonomike të Kosovës rregullohet themelimi, anëtarësia, selia, statusi, qëllimi, organet, roli dhe fushëveprimi i Odës Ekonomike të Kosovës. OEK-ës është organizatë profesionale jofitimprurëse dhe subjekt juridik i pavarur. Anëtarësimi i personave fizik dhe juridik që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Kosovë apo që kanë selinë e vet në Kosovë, është vullnetar.

Ky ligj zbatohet edhe për organizatat tjera të subjekteve ekonomike dhe organizatat në lëmin e shkencës, shoqatat profesionale dhe shoqatat tjera të cilat i bashkohen me aktivitetin e vet e që e përparojnë afarizmin e subjekteve ekonomike.

**Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, respektivisht Departamenti i Tregtisë** është përgjegjës për hartimin e kornizës ligjore për OEK-ës. Me datë 29 Mars 2022, me vendimim me numër të protokollit 1910-02, Sekretari i Përgjithshëm i MINT ka formuar grupin punues për hartimin e draftit fillestar të Koncept Dokumentit për Odën Ekonomike të Kosovës.

Ky koncept është përfshirë edhe në listën e Koncept Dokumenteve për vitin 2022.

Bazuar në Udhëzuesin dhe doracakun për hartimin e koncept dokumenteve është hartuar ky Koncept Dokument i cili do të propozoj opsionin e rekomanduar nga grupi punues bazuar në analizën lidhur me Ligjin në fuqi Nr. 2004/7 Për Odën Ekonomike të Kosovës. Po ashtu është marrë në konsideratë edhe Raporti “Krahasimi i Legjislacionit të Odës në gjashtë shtete të Ballkanit Perëndimor” në të cilin konkludohet se anëtarësia e detyrueshme bëhet një domosdoshmëri kur një odë nuk vepron vetëm në interes të anëtarëve të saj, por edhe në interes të së mirës publike, siç është rasti me odat që kryejnë funksione publike në emër të Shetitit.

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Odën Ekonomike të Kosovës
Ministria bartëse	<b>Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë</b>
Personi kontaktues	Igballe Rexha-Jashari, zv Drejtore e Departamentit të Tregtisë <a href="mailto:Igballe.Rexha@rks-gov.net">Igballe.Rexha@rks-gov.net</a>
PKZH	Hartimi i koncept dokumentit për Odën Ekonomike është planifikuar në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim (PKZH) të Qeverisë së Republikës së Kosovës, aktivitet ky i planifikuar për vitin 2023 në kuadër të shtyllës/veprimtarisë; Ambienti i biznesit, masa strategjike; Përmirësimi i rregullatorit, unifikimi dhe përmirësimi i shërbimeve ndaj biznesit, aktiviteti; Hartimi dhe miratimi i koncept dokumentit për odën ekonomike të Kosovës.
Prioriteti strategjik	Ky Koncept Dokument ndërlidhet ngushtë me objektivat Strategjisë në kuadër të Programit të Qeverisë së Kosovës 2021-2025, në kuadër të kapitullit 2.8 Industria, ndërmarrësia dhe tregtia; në mënyrë indirekte është potencuar rëndësia e zhvillimit të politikave industriale dhe tregtare me qëllim të përmirësimit të dialogut publiko-privat, bashkëpunim i strukturuar me komunitetin e biznesit me qëllim për zhvillim të përgjithshëm ekonomik.
Grupi punues	• Igballe Rexha-Jashari, (MINT-DT) zv. Drejtore e Departamentit të Tregtisë - Kryesuse;

## Koncept dokumenti për Odën Ekonomike të Kosovës

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bulinë Gashi - (MINT-DT) Zyrtare e Lartë për Analiza të Tregut dhe Politikave Tregtare - anëtare;</li> <li>• Rexhep Bllaca - (MINT-DT) Drejtor i Zyrës Ligjore- anëtar;</li> <li>• Zef Dedaj - (MINT-KIESA) zv. Kryeshef në KIESA</li> <li>• Valbone Dushi - (MINT-DI) Udhëheqëse e Departamentit të Industrisë – anëtare;</li> <li>• Mevlyde Beqiri - (MINT) Udhëheqëse e Divizionit për buxhet dhe financa- anëtare;</li> <li>• Parim Bajrami, OEK</li> <li>• Nehat Rrahimi, ME</li> <li>• Arjeta Islami Muja, Udhëheqëse e Divizionit për Integrim Evropian/ DIEK</li> <li>• Daut Latifaj, zv. Udhëheqës i Divizionit për Zbatimin dhe Përgatitjen e Projekteve të Investimeve Strategjike (MINT/DIS)</li> <li>• Mentor Sylmeta, Drejtor i Departamentit të Ndërmarrësisë (MINT/DN)</li> <li>• Laura Zherka, Drejtore e Departamentit për Inovacione</li> <li>• Shkurta Krasniqi, ZKM/SKQ</li> <li>• Albulena Blaku, MFPT</li> </ul>
Informata shtesë	Nuk ka informata shtesë

### Vendimi

Vendimi	
Çështja kryesore	Ndërveprimi i organizuar me nivele të ndryshme të Qeverisë, qasja e garantuar tek Kuvendi dhe agjencionet dhe pjesëmarrja zyrtare në politikat dhe proceset legjislative
Përmbledhje e konsultimeve	Takimet – planifikimi (të caktohen nga GP)
	Konsultime tjera do të zhvillohen gjatë procesit të konsultimit paraprak dhe publik të paraparë me Rregulloren e Punës së Qeverisë. Data e fillimi të konsultimit publik është 27.03.2023
Opsioni i propozuar	Ligji i ri për Odën Ekonomike të Kosovës

## Kapitulli 1: Përkufizimi i Problemit

- Preambula (është me llogo UNMIK)  
*Në Ligjin aktual të OEK-ut, Preambula bazohet në Rregulloren e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë - UNMIK, para shpalljes së pavarësisë.*
- Antarësimi është vullnetar.  
*Neni 2 Paragrafin 2.1 të Ligjit për OEK-un, theksohet se “Në OEK në pajtim me këtë ligj antarësimi i personave fizik dhe juridik që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Kosovë apo që kanë selinë e vet në Kosovë është vullnetar. Mesatarisht në Odën Ekonomike të Kosovës janë të antarësuar rreth 21, 000 biznese.*
- Nuk është i definuar statusi i anëtarit të ODA-s dhe i shoqatave i cili duhet të rregullohet me Ligj  
*Në ligjin aktual nuk është e definuar se si rregullohet statusi i anëtarit, kriteret bazike për antarësim, kohëzgjatja e antarësimit, nivelet e antarësimit, ndërprerja-revokimi i antarësisë. Gjithashtu nuk janë të rregulluara, kategorizuara, nivelet e antarësimit në OEK, sa i përket tarifave.*  
*Odën e qeverisin antarët e saj përmes përfaqësuesve të tyre nëpër shoqata, njësi rajonale dhe përmes antarëve të zgjedhur në organet e Odës. Anëtari i Odës konsiderohet subjekti juridik apo fizik që nënshkruan Marrëveshjen për Antarësim në Odë. Antarësimi në OEK rrjedhë nga dita e nënshkrimit të kontratës – Marrëveshjes për antarësim në OEK.*  
*Në Marrëveshjen e Antarësimit në OEK, janë të specifikuar nivelet e antarësimit dhe të drejtat dhe obligimet reciproke të palëve për secilin nivel. Mos-përmbushja e detyrimeve bazë të parapara me marrëveshjen e antarësimit nga cila do palë kontraktuese, paraqet shkelje të dispozitave të Statutit të Odës. Në rast të shkeljeve të tilla, pala e dëmtuar do t'i paraqet Gjykatës së Nderit rastin për shqyrtim ku do të nxjerrën rekomandimet përkatëse në pajtim me Statutin e Odës.*
- Mënyra, kriteret, përfaqësimi dhe revokimi i zgjedhjes së organeve drejtuese të ODA-s, do të rregullohet me Ligj (Kuvendi, Këshilli drejtues dhe Këshilli mbikëqyrës nuk e kanë të definuar numrin e antarëve).  
*Me ligjin aktual të OEK-ut nuk janë të definuara kriteret e zgjedhjes së organeve drejtuese të OEK-ut, do të definohet numri i antarëve të Kuvendit, Këshillit drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës me ligjin e ri të OEK.*  
*Oda Ekonomike e ka Rregulloren për formën, kriteret dhe mënyrën e votimit dhe përfaqësimit, në organet qeverisëse të Odës Ekonomike të Kosovës, e cila derivon nga Statuti i OEK-ut. Në këtë rregullore janë të detajuar në mënyrë eksplicite mënyra, kriteret, përfaqësimi dhe revokimi i zgjedhjes së organeve drejtuese të OEK-ut-(Kuvendi, Këshilli drejtues dhe Këshilli Mbikëqyrës).*  
*Me Rregulloren për formën, kriteret dhe mënyrën e votimit dhe përfaqësimit, në organet qeverisëse të Odës Ekonomike të Kosovës janë të definuara kriteret e zgjedhjes së organeve*



*drejtuese të OEK-ut. Me Statusin e Odës Ekonomike të Kosovës është i definuar numri i anëtarëve:*

- *Kuvendi i Odës ka 71 anëtarë,*
- *Këshilli Drejtues ka 17 anëtar, kurse*
- *Këshilli Mbikqyrës ka 5 anëtarë.*

- *Mënyra e funksionimit të shoqatave dhe njësisve rajonale nuk është e definuar në ligjin aktual të Odës*

*Me Ligjin në fuqi, nuk është e definuar mënyra e themelimit të shoqatave sektoriale dhe Njësive Rajonale, statusi i tyre juridik, rregullimi i brendshëm, selia, shtrirja teritoriale, struktura organizative, financimimi dhe menaxhimi i tyre dhe ndërlidhje me aktet e OEK-ut.*

*Mirepo me Statutin e Odës Ekonomike është e rregulluar forma e organizimit të shoqatave, numri i anëtarëve për themelimin e një shoqate, pastaj ndarja e shoqatave sipas veprimtarive, financimi i tyre si dhe forma e organizimit të tyre. Poashtu Statuti e ka rregulluar themelimin e Njësive Rajonale. Njësia Rajonale është formë territoriale e organizimit dhe punës në kuadër të Odës, përmes funksionimit të së cilës sigurohet decentralizimi i detyrave dhe aktiviteteve të Odës dhe vendimmarrje e pavarur e anëtarëve të Odës për çështje dhe detyra me rëndësi të veçantë për rajonin për territorin e të cilit është organizuar njësia. Njësia Rajonale mund të organizohet për dy ose më shumë komuna. Njësia Rajonale ka Këshillin Drejtues si organ qeverisës dhe Kryetarin e saj. Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhen në mbledhjen e Kuvendit të Njësisë Rajonale, nga radhët e përfaqësuesve të anëtarëve të Odës nga rajoni i Njësisë Rajonale.*

- *Nuk është i definuar roli dhe kompetenca e Këshillit të Nderit dhe Arbitrazhit*

*Me ligjin aktual është e definuar se Këshilli i Nderit dhe Arbitrazhi i Përhershëm pranë OEK-ut e shtrijnë kompetencën e tyre vetëm mes anëtarëve të OEK-ut dhe anëtarëve dhe personave tjerë juridik ose fizik.*

*Mirëpo me Statutin e OEK-ut, Aktin e themelimit të arbitrazhit dhe me Rregullat e arbitrazhit, janë të definuara në mënyrë konkrete, roli dhe kompetenca e Arbitrazhit si dhe Gjykatës së Nderit.*

*Me Rregullat e arbitrazhit të cilat janë në fuqi, në mënyrë eksplicite është e rregulluar se këto rregulla udhëheqin arbitrazhin vendor dhe ndërkombëtar të mosmarrëveshjeve në lidhje me një marrëdhënie të përcaktuar ligjore, kontraktuese apo jokontraktuese, ku një marrëveshje i referohet këtyre rregullave në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK). Institucioni i tillë i cili administron procedurën e arbitrazhit sipas këtyre rregullave në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës është Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit.*

- *Nuk ka kritere për kategorizimin për tarifatat, për shumën/vlerën, e anëtarësisë*

*Nuk janë të definuara nivelet e anëtarësisimit, kategorizimi dhe tarifatat e anëtarësisimit, si dhe ndërprerja-revokimi i anëtarëve.*

*Sipas Statutit, Kuvendi e miraton vendimin për financimin e OEK-ut, i cili përcakton mënyrën e financimit, lartësinë, kushtet dhe afatet e pagesës së anëtarësisë në OEK si dhe*

*çështje tjera të cilat ndërlihen me pagesën e anëtarësisë. Vendimin për anëtarësi, Kuvendi e merr çdo vit paraprak.*

*Lartësia e anëtarësimi për çdo nivel të anëtarësisë në OEK, përcaktohet nga Kuvendi në bazë të Planit financiar të aprovuar paraprakisht.*

*Me statutin e OEK-ut Kuvendi e përcakton përqindjen e kuotes së antarësisë, pastaj sipas kësaj janë të përcaktuara edhe tri nivele të antarësimi, ku Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës me Shoqatat e caktuara për arsye të numërit të anëtarësisë, obligohet që të negociojë dhe arrij marrëveshje për shumën e anëtarësisë që duhet të paguajnë anëtarët apo shoqata në emër të anëtarëve. Kjo formë është e rregulluar me Statut si dhe akte tjera të brendshme të OEK-ut*

*Po ashtu është edhe Pako e re e anëtarësisë e cila është e përcaktuar nga ana e Kuvendit të OEK-ut, ku anëtarët me vetë dëshirë e përcaktojnë nivelin e anëtarësimi në bazë të shërbimeve.*

Megjithatë, gjatë zbatimit të ligjit në fuqi janë paraqitur dhe prodhuar “efekte” të cilat kanë rrjedhur si rezultat i disa fenomeneve të cilat gjatë hartimit të këtij koncept dokumenti grupi punues i ka përcaktuar si “shkaqe”. Disa nga këto shkaqe janë përcaktuar dhe identifikuar nga grupi punues duke u bazuar në eksperiencën e punës me ligjin në fuqi.

#### **Disa nga këto shkaqe të identifikuar përfshijnë si në vijim:**

- Mosdefinimi i qartë i rolit dhe kompetencave të anëtarëve dhe organeve drejtuese
- Mangesi Ligjore në Ligjin aktual
- Mosdefinimi dhe kategorizimi i tarifave për anëtarësinë

Si pasojë, këto shkaqe, të cilat u përmendën më sipër, kanë prodhuar efekte të pa dëshiruara siç është përfaqësimi i limituar i bizneseve anëtare.

E gjithë analiza e shkaqeve dhe efekteve e ka ndihmuar grupin e punës për koncept dokumentin që të përcaktojë saktë përkufizimin e problemit i cili është përcaktuar:

Problemi kryesor, duke i marr parasysh shkaqe dhe efektet është **“Mangësitë dhe paqartësitë gjatë zbatimit të Ligjit”**, të cilat janë paraqitur në figurën 4.

*Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore*

<i><b>Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor</b></i>	<i><b>Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare</b></i>	<i><b>Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim</b></i>	<i><b>Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)</b></i>
Ligji për Odën Ekonomike të Kosovës NR 2004/7	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2475">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2475</a>	MINT dhe OEK	Zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga i kornizës ligjore MINT dhe OEK.
Statusi i Odës i Ekonomike të Kosovës	<a href="https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2018/January/18/Statuti_si_nged1516262305.pdf">https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2018/January/18/Statuti_si_nged1516262305.pdf</a>	OEK	Zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga korniza ligjore OEK

Rregullore e punës së kuvendit të Odës Ekonomike të Kosovës	<a href="https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2019/August/26/Rregullorja_e_Re_e_Kuvendit_te_EK-ut_2018_f1566804275.pdf">https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2019/August/26/Rregullorja_e_Re_e_Kuvendit_te_EK-ut_2018_f1566804275.pdf</a>	OEK	Zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga korniza ligjore OEK
Rregulloren mbi mënyren e punës së këshillit drejtues të Odës Ekonomike të Kosovës	<a href="https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2019/August/26/Rregullorja_e_Keshillit_Drejtues_20.07.2018_f1566803025.pdf">https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2019/August/26/Rregullorja_e_Keshillit_Drejtues_20.07.2018_f1566803025.pdf</a>	OEK	Zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga korniza ligjore OEK
Rregullore e punës së këshillit mbikëqyrës të Odës Ekonomike të Kosovës	<a href="https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2021/March/02/Rregullorja_e_KM_Final1614690927.pdf">https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2021/March/02/Rregullorja_e_KM_Final1614690927.pdf</a>	OEK	Zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga a korniza ligjore OEK

Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

<b>Efektet</b>	1. Dëmtimi i bizneseve
	2. Dëmtimi i shoqatave
<b>Problemi kryesor</b>	<b>Mangësitë dhe paqartësitë gjatë zbatimit të Ligjit</b>
<b>Shkaqet</b>	1. Mosdefinimi i qartë i rolit dhe kompetencave të anëtarëve dhe organeve drejtuese
	2. Mangësi ligjore të Ligjit aktual
	3. Mosdefinimi dhe kategorizimi i tarifave për anëtarësinë

## Shkaqet

### 1. Mosdefinimi i qartë i rolit dhe kompetencave të anëtarëve dhe organeve drejtuese

**Analiza 1:** Në OEK në pajtim me këtë ligj, neni 2 pika 2.1, anëtarësimi i personave fizik dhe juridik që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Kosovë apo që kanë selinë e vet në Kosovë është vullnetar. Në OEK mund të bashkohen edhe organizata tjera të subjekteve ekonomike dhe organizatat në lëminë e shkencës, shoqatat profesionale dhe shoqatat tjera të cilat me aktivitetin e vet e përparojnë afarizmin e subjekteve ekonomike. Në Odën Ekonomike të Kosovës janë të anëtarësuar rreth 21, 000 biznese. Ndërsa, sipas të dhënave të ARBK janë të regjistruara 95,813 biznese aktive.

### **Analiza 2.** Mosdefinimi dhe kategorizimi i tarifave për anëtarësinë, me Ligj

Në nenin 17 pika f, të Ligjit aktual, Kuvendi e ka kompetencën që të përcakton përqindjen e kuotës së anëtarësisë dhe vendos për shpërndarjen e mjeteve financiare për nevojat e punës të OEK-së në nivel qëndror, si dhe në shkallë shoqatash të degëve dhe njësisish rajonale;

## Efektet

1. Numri i vogël i bizneseve të anëtarësuara – mosinteresimi i bizneseve për të qenë anëtarë të OEK për arsye të anëtarësimit vullnetar si dhe jokategorizimi ligjor i pagesave për anëtarësim.
2. Mosdefinimi i qartë i statutit të shoqatave të bizneseve – Shoqatat e bizneseve nuk e kanë statutin e definuar si dhe shoqatat të cilat janë të regjistruara si OjQ mund ta gëzojnë të drejtën e përfituesit me të drejta të benificuara siç është lirimi nga TVSH. Poashtu shoqatat janë të dëmtuara për shkak të mosnjohjes së statutit nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Në vijim, figura e mëposhtme liston palët e interesuara të identifikuar. Gjithashtu tregon nëse ato janë prekur nga shkaqet, efektet ose të dyja. Përveç kësaj, kolona e fundit në përmbledhje tregon se si ato janë të prekura. Kapitulli 5 jep informacionin se si janë konsultuar këto palë të interesuara.

*Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit*

<b>Emri i palës së interesuar</b>	<b>Shkaku-qet dhe/ose efekti (efektet) me të cilat është e lidhur pala</b>	<b>Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)</b>
Bizneset	Mangësitë ligjore  - Mosdefinimi i qartë i rolit dhe kompetencave të anëtarëve dhe organeve drejtuese  -Mosdefinimi dhe kategorizimi i tarifave për anëtarësinë	Pamundësia e avokimit efikas të interesave të bizneseve dhe gjithpërfshirja në përfaqësim
Shoqatat e bizneseve	Shoqatat e bizneseve nuk e kanë statutin e definuar, përderisa shoqatat e bizneseve të cilat janë të regjistruara si OjQ mund ta gëzojnë të drejtën e përfituesit me të drejta të benificuara siç është lirimi nga TVSH.	Shoqatat e bizneseve janë të dëmtuara për shkak të mosnjohjes së statutit nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

## Kapitulli 2: Objektivat

Me kornizën ligjore të përmirësuar synojmë mbrojtjen e interesave të bizneseve dhe shoqatave të bizneseve në Kosovë si dhe që të arrijmë përputhshmëri më të lartë me standardet dhe praktikën e Bashkimit Evropian.

### Ndërlidhja me dokumentet relevante:

Hartimi i Koncept Dokumentit për Odën Ekonomike është planifikuar në kuadër të Programit Strategjik dhe Operacional (PSO) të Qeverisë së Republikës së Kosovës, aktivitet ky i planifikuar për vitin 2022 në kuadër të shtyllës 1. Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe zhvillimi i konkurrueshmërisë në sektorin privat, nënshlylla 1.2 Përmirësimi i kornizës Ligjore për Odën Ekonomike.

Poashtu në kuadër të Programit të Qeverisë së Kosovës 2021-2025, në kuadër të kapitullit 2.8 Industria, ndërmarrësia dhe tregtia; në mënyrë indirekte është potencuar rëndësia e zhvillimit të politikave industriale dhe tregtare me qëllim të përmirësimit të dialogut publiko-privat, bashkëpunim i strukturuar me komunitetin e biznesit me qëllim për zhvillim të përgjithshëm ekonomik.

Në kuadër të procesit për Integrim Evropian, edhe pse specifikisht hartimi i këtij koncept dokumenti nuk është i përfshirë në PKZMSA për vitin 2022, në aspektin e përgjithshëm rregullat e tregut të përbashkët Evropian (mallra dhe shërbime) kërkojnë asociacione (trupa) profesionale të themeluara me statute dhe akte ligjore me vendimmarrje autonome të cilat i asistojnë institucionet vendore dhe bashkëpunojnë me po të njëjta asociacione jashtë vendit për qëllim të tregut të përbashkët dhe shkëmbim të informacioneve tregtare etj.

Figura 5: Objektivat relevante të Qeverisë

Qëllimi i politikës	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
Strategjik – përkrahja e bizneseve	PSO PRE PKZMSA
Specifik –	<i>Strategjia Kombëtare për Zhvillim</i> Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, kemi shtyllën e parë të strategjisë që si objektivi kryesor ka 1. Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Në kuadër të kësaj objektivë rezultojnë disa objektiva të tjera strategjike me çrast roli i Odës ekonomike apo organizatat tjera të subjekteve ekonomike dhe organizatat në lëminë e shkencës, shoqatat profesionale dhe shoqatat tjera të cilat i bashkohen me aktivitetin e vet dhe kanë për qëllim të përparojnë afarizmin e subjekteve ekonomike mund të konsiderohen shumë të rëndësishme. Synimi kryesor i kësaj shtylle është që të mundësohet prani më e madhe e ndërmarrjeve të Kosovës në tregje ndërkombëtare dhe duke pasur parasysh që organizatat apo asociacionet e ndryshme të bizneseve

## Koncept dokumenti për Odën Ekonomike të Kosovës

	kanë bashkëpunim më organizata të ngjajshme ndërkombetare, atëhere roli i tyre në realizimin e këtyre objektivave është shumë i rëndësishëm.
--	--

### Kapitulli 3: Opsionet

Nga grupi punues janë trajtuar gjithsej tri opsione për adresimin e problemit të identifikuar më lartë dhe arritjen e objektivave. Këto opsione janë: 1) opsioni asnjë ndryshim; 2) opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore; 3) opsioni që parasheh ndryshime ligjore.

#### Krahasimi me vendet tjera

Grupi punues gjatë përgatitjes së këtij Koncept Dokumenti, ka marr parasysh përvojat e Kroacisë dhe Malit të Zi, për të krahasuar çështje të identifikuar në Kapitullin 1 dhe që janë konsideruar të rëndësishme për të i krahasuar. Këto shtete janë zgjedhur për arsye të ngjashmëris së sistemit juridik me vendin tonë si dhe bashkpunimin e OEK me ODA-t homologe.

Po ashtu është marrë në konsideratë edhe Raporti “Krahasimi i Legjislacionit të Odës në gjashtë shtete të Ballkanit Perëndimor” si dhe Hulumtimi mbi Modelet e Organizmit të Odave (SHBA, Gjermania, Franca, Austria dhe Italia)

Figura 6: Krahasimi i problemeve të idetifikuar në Kosovë me vendet e Rajonit

Çështja e trajtuar	Kosova	Kroacia	Mali i Zi
<b>Rregullimi Ligjor i anëtarësisë (obligative/vullnetare)</b>	Ligji për OEK 2004/7 bazuar në Rregulloren e UNMIK, me anëtarësi vullnetare	Ligji për Odën Ekonomike të Kroacisë Nr.71-10-01/1-21-2 Anëtarësimi është obligativ për të gjithë personat juridik që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territor e RK, të regjistruara në regjistrin gjyqësor. Në Odë vullnetarisht mund të regjistrohen edhe subjektet tjera shoqërore, arsimore, shoqatat etj.	Ligji për Odën Ekonomike të Malit të Zi Nr.01-1140/2 (2017). Ndërmarrjet ekonomike, bankat dhe organizatat tjera financiare, organizatat e sigurimeve dhe ndërmarrësit tjerë që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Malit të Zi, me automatizëm bëhen anëtare të Odës në ditën e regjistrimit në Regjistrin qendror të subjekteve afariste.
<b>Rregullimi i Statutit të anëtarëve, kategorizimi dhe tarifave të anëtarësimi</b>	Anëtarësimi në OEK rrjedh nga dita e nënshkrimit të kontratës për anëtarësim. Shuma e kontributit të anëtarëve dhe kushtet e pagimit caktohen me vendim të Kuvendit të OEK në pajtim me ligjin. Nuk janë të definuara nivelet e anëtarësimi, kategorizimi dhe tarifave të anëtarësimi, si dhe ndërprerja-revokimi i mandatit të anëtarëve.	Anëtarësimi rrjedh nga dita e regjistrimit në regjistrin gjyqësor dhe detyrimet e anëtarësisë në Odë bazohen në forcën ekonomike të ndërmarrjes. Forca ekonomike e anëtarëve të Odës përcaktohet duke i klasifikuar në grupime sipas këtyre të dhënave: aktiva e përgjithshme; shumës së të hyrave dhe numrit mesatar të të punësuarve gjatë vitit afarist, të cilat janë të paraqitura në raportet vjetore financiare të anëtarit për vitin paraprak. Varësisht nga forca ekonomike anëtarët e Odës klasifikohen në tri grupe. Lartësinë (shumën) e anëtarësimi për secilin grup të	Vlerësimin e bazës-lartësisë së kontributit të anëtarësisë, mënyren dhe afatet e pagesës i përcakton Kuvendi i Odës me vendim, i cili publikohet në Gazeten zyrtare të Malit të Zi. Kontrollin e pagesave të kontributeve të anëtarësisë e bën organi i Administratës shtetërore në kompetencën e të cilit është përcaktimi-vendosja dhe kontrolli i tatimeve.

Koncept dokumenti për Odën Ekonomike të Kosovës

Çështja e trajtuar	Kosova	Kroacia	Mali i Zi
		<p>anëtarëve të Odës e cakton Kuvendi i Odës me Vendim. Anëtarët e Odës që i takojn grupit të parë, nuk kanë obligim për pagesen e anëtarësisë, ata munden të paguajn vetëm për shërbime tjera specifike.</p>	
<p><b>Organizimi i anëtarësisë në shoqata profesionale dhe njësi rajonale.</b></p>	<p>Shoqatave sektoriale-profesionale në OEK nuk u njihet statusi i tyre ligjor-numëri identifikues i regjistrimit sepse nuk mund të regjistrohen as si biznese (ARBK) e as si OJQ në Dep. i OJQ-ve pranë MPB.</p>	<p>Oda territorialisht është e rajonalizuar në Odat e Zhupanisë. Odat e Zhupanisë janë në kuadër të Odës, me rolin dhe mandatin e përcaktuar me aktet e përgjithshme të Odës të përcaktuara në Ligjin dhe Statutin e Odës.</p>	<p>Rregullohet me Statutin dhe aktet tjera të Odës</p>
<p><b>Mënyra dhe kriteret e zgjedhjes, përfaqësimit dhe revokimit të organeve drejtuese.</b></p>	<p>Nuk definohet numri i anëtarëve të organeve drejtuese të Odës, dhe revokimit të mandateve të tyre.</p>	<p>Kuvendi i Odës ka së paku 77 anëtarë dhe jo më shumë se 101 anëtarë. Këshilli Drejtues ka 7 anëtarë, Këshilli Mbikqyrës ka 5 anëtarë. Kryetari i Odës detyrat e tij mundet ti ushtroj duke themeluar mardhënje të rregullt pune në Odë, apo edhe duke mos themeluar mardhënje të rregullt të punës në Odë.</p>	<p>Rregullohet me Statutin e Odës.</p>
<p><b>Kompetenca dhe fushëveprimi i Arbitrazhit dhe Këshillit të Nderit</b></p>	<p>Me ligjin e Odës është e definuar se Këshilli i Nderit dhe Arbitrazhi i Përhershëm pranë OEK-ut e shtrijnë kompetencën e tyre vetëm mes anëtarëve të OEK-ut dhe anëtarëve dhe personave tjerë juridik ose fizik. Këshilli i nderit kujdeset për zhvillimin, realizimin dhe ruajtjen e zakoneve të mira afariste, vendos për shkeljet e Statutit, dokumenteve të tjera dhe vendimeve të organeve të Odës, merr Vendime për dënime administrative jo-monetare, masa disiplinore etj.</p>	<p>Personat fizik dhe juridik vendor dhe të jashtëm, munden të lidhin marrëveshjen për kompetencën e e Gjykatës së përhershme të Arbitrazhit të Odës, për pajtim apo vendosjen e kontesteve për të cilat ka kompetencë, nëse me Ligj nuk është e rregulluar që për kontestet specifike egziston përjashtimisht kompetenca e gjykatave të rregullta Gjykata e Nderit vendos për shkeljet e zakoneve të mira si dhe mospërbushjen e obligimeve të anëtarëve të Odës dhe shkeljeve tjera të Statutit dhe akteve të përgjithshme të Odës. Oda ka dhe Qendren për Pajtim e cila ofron shërbime në lidhje me procedurën e pajtimit në të cilën një apo më shumë pajtues u ndihmojnë palëve të përfundojnë një zgjidhje në</p>	<p>Në Odë vepron Gjykata e Arbitrazhit. Kjo Gjykatë aplikon procedurat e abitrazhit në harmoni me rregullat e Ligjit të Arbitrazhit, njohjen dhe egzekutimin e vendimeve të arbitrazhit. Oda organizon dhe siguron kushtet për punën e Gjykatës së Arbitrazhit. Pranë Odës vepron Gjykata e Nderit. Kjo Gjykat vendos në procedurë për shkeljet e sjelljeve dhe zakoneve të mira afariste të anëtarëve të Odës. Organizimi, përbërja, procedurat, puna e saj dhe masat të cilat i shqipton Gjykats e Nderit rregullohen me Aktin e Odës.</p>



Çështja e trajtuar	Kosova	Kroacia	Mali i Zi
		<p>mosmarrëveshjet civile, tregtare dhe mosmarrëveshje tjera pronësore brenda të drejtave të cilat kanë kompetencë. Pajtimi i arritur pranë Qendrës së Pajtitimit është dokument i egzekutueshëm.</p> <p>Organizimi, kompetencat dhe procedurat pranë Qendrës së Pajtitimit rregullohen në harmoni me ligjin për pajtim dhe rregullores të nxjerr nga Kuvendi i Odës.</p>	

*Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim*

**Opsioni asnjë ndryshim** do të ruante status quon dhe problemi ekzistues “**Mangësitë dhe paqartësitë gjatë zbatimit të Ligjit**” do të vazhdonte të këtë mosdefinimin të qartë të rolit dhe kompetencave të anëtarëve dhe organeve drejtuese të OEK. Ky opsion nuk i kategorizon tarifatat për anëtarësinë. Gjithashtu, status quo do të lejonte hapësirë për konfuzitet në interpretim të ligjit, përzierje të kompetencave mbrenda OEK.

*Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore*

Opsioni për ‘përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit’ është një opsion që e parashikon procedura e hartimit në çdo Koncept Dokumenti në përputhje me Udhëzuesin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Ky opsion parashih mënyrat për arritjen e objektivave përmes zbatimit të duhur të detyrimeve ekzistuese ligjore. Në këtë rast, grupi punues pas diskutimeve dhe analizave gjatë punëtorive të mbajtura kanë propozuar që ekziston mundësia të arrihen objektivat e koncept dokumentit duke e përmirësuar zbatimin e duhur të detyrave ekzistuese ligjore përmes ndarjes së buxhetit shtesë në rast se dispozitat aktuale buxhetore nuk janë të përshtatshme për arritjen e objektivave. Në këtë mënyrë mundësohet që me buxhet të shtuar të synohen dy objektiva bazë siç janë; rritja e numrit të stafit, trajnimeve, inspektimeve, si dhe aktiviteteve shtesë për ofrimin e shërbimeve për bizneset.

Por në anën tjetër, ky opsion do t’i adresonte deri në një masë të caktuar efektet dhe shkaqet të cilat shpiten tek problemi kryesor që po analizohet në këtë Koncept Dokument. Gjithashtu, problemet që janë identifikuar në këtë Koncept Dokument janë kryesisht të ndërlidhura me bazën aktuale ligjore dhe si e tillë mund të adresohen vetëm me ndërhyrje në dispozitat ligjore në fuqi. Kështu që, në këtë rast do të duhej të merret parasysh efektet e kostove totale buxhetore të këtij opsioni si dhe fakti që arritja e objektivave, në pjesë të madhe është e bazuar në parashikime dhe paragjykimet.

*Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë*

Problemi që është identifikuar në këtë Koncept Dokument “**Mangesitë dhe paqartësitë gjatë zbatimit të Ligjit**” është kryesisht i ndërlidhur me bazën aktuale ligjore. Rrjedhimisht, çfarëdo përmirësimi në zbatimin dhe ekzekutimin e dispozitave përkatëse ligjore në fuqi nuk do të prodhoni zgjidhje për problemin e identifikuar.

Opsioni i tretë, në anën tjetër, si mbas gjykimit dhe analizave të grupit punues paraqet opsionin që do të shkonte përtej përmirësimit të zbatimit dhe ekzekutimit të kornizës aktuale ligjore. Andaj, propozimi në këtë rast është për të draftuar ligjin e ri.

Me ligjin e ri definohej qartë roli dhe kompetencat e anëtarëve dhe organeve drejtuese të OEK. Poashtu kategorizohen tarifat për anëtarësinë. Gjithashtu rregullohet që tribunali i përhershëm i arbitrazhit mund të vendos për konteste reciproke afariste në mes të anëtarëve të Odës, anëtarëve të Odës dhe personave të tretë si dhe në mes të personave të tjerë juridik dhe të jashtëm, nëse palët dakordohen për kompetencën e kësaj gjykate.

Ky opsion është edhe rekomandim nga grupi punues i Koncept Dokumentit. Përmes këtij opsioni synohet të arrihet ndryshimi i politikave ekzistuese, më konkretisht përmes hartimit të ligjit të ri për OEK, i cili do të duhet të merrte për bazë rekomandimet e më poshtme të dala nga analiza e këtij Koncept Dokumenti:

